



01 Nr. 599/24 Dt. 01.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të faturës të papaguar të energjisë elektrike (rrymës) të krijuar (shpenzuar), në objektin i cili gjendet në rr. "Adem Jashari" në Prizren, kështu që, në emër të pagesës së faturës përkatëse (borxhit) të Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO), përkatësisht për faturën e papaguar për njuhësorin me nr. DPZ [REDACTED] lejohen mjetet financiare në shumën prej 758.30 € (shtatëqind e pesëdhjetë e tetë euro e tridhjetë cent).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve dhe shpenzime komunale të Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.